

Luigj Dedvukaj
Tuz (Malësi)

XHUBLETA - VESHJA TRADICIONALE E NUSES MALËSORE

Veshjet popullore shqiptare janë të larmishme e shumë të pasura dhe dallohen për nga ndarja etnografike krahinore, gjinia, mosha, qepja, punimi artistik, struktura, materiali etj., ku përmes veshjeve janë dalluar klasat a shtresat shoqërore, pra është dalluar gjendja statusore civile e familjeve dhe e individit.



Foto 1. Nusja me xhubletë gjatë kthimit në të djathtë¹

¹ Fotografia është marrë nga arkivi personal i At' Pashko Gojçaj.

Shikuar nga aspekti historik, ndër kostumet më të vjetra në Evropë dallohet veshja me xhubletë, karakteristike për zonën e Veriut të Shqipërisë. *Për xhubletën kanë shkruar shumë studiues të fushave të ndryshme, saqë kanë mendime se është edhe para ilirëve nga qytetërimi kreto-mikenas dhe ka lidhje me figurinën e Kliçevaçit që i përket mijëvjeçarit të dytë para erës sonë, e cila mund të konsiderohet një paraardhëse e hershme e xhubletës sonë*². Siç duket, xhubleta vjen nga lashtësia, e trashëguar dhe e ruajtur, për nga trajta, pothuajse në mënyrë origjinale deri në ditët tona. Sot, xhubleta së bashku me aftësitë, mjeshtërinë dhe format e përdorimit është regjistruar në Listën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale në Nevojë për Mbrojtje Urgjente në UNESCO (Vendimi i Komitetit Ndërqeveritar i UNESCO-s: 17.com 7.a.4, viti 2022)³ dhe është pasuri e gjithë njerëzimit.

Xhubleta na asocion menjëherë me gjininë femërore të arealit kulturor të Alpeve shqiptare, me vajzën dhe gruan malësore, e sidomos me nusen malësore, e karakterizuar nga forma e saj e valëzuar e ziles me stolitë e shumta mahnitëse. Xhubleta e nuses ishte ajo më madhështorja me stoli disakilogramëshe, që femrës së shëndetshme, të gjatë e të plotë në fytyrë i rrinte më së miri, e hijeshonte duke i reflektuar fuqinë e saj fizike, shtatlartësinë, përballjen me punët e përditshme fizike dhe jetën në rrethanat jo të përshtatshme klimatike, ekonomike dhe shoqërore, dhe siç thonë malësorët: “xhubleta e bukur gjithmonë e ka burrëruar dhe hijeshuar femrën”.⁴ Veshjes dhe stolive për martesë u kanë dhënë rëndësi, në punimin artistik dhe përzgjedhje, aq sa kanë pasur mundësi ekonomike dhe vazhdojnë t’i vlerësojnë në mënyrë që çifti të dalë sa më i bukur e i hijshëm, sidomos nusja sa më *daji*⁵ e dhëndri sa më sokol. Si veshja, ashtu edhe çifti ndërlidhen nga këndvështrimi estetik, simetrik dhe në harmoni me ngjyrat, duke krijuar

² Andromaqi Gjergji, *Veshjet shqiptare në shekuj*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, 2005), f. 166.

³ <https://ich.unesco.org/en/USL/xhubleta-skills-craftsmanship-and-forms-of-usage-01880>

⁴ Shtjefën Kola Ujkaj, *Vallet dhe lojërat e Malësisë*, (Tuz: Sh. Ujkaj, 2019), f. 39.

⁵ Dai.

proporcionalitetin e nevojshëm. Jo vetëm çifti që martohej, por gjithashtu edhe të ftuarit që vinin në dasmë u kanë dhënë rëndësi përzgjedhjes dhe shijes së veshjes. Ata në dasmë shkonin me veshje sa më të bukura, femra me xhubletë, kurse mashkulli me çakçirë e xhamadan, mundësisht të reja, nëse jo, atëherë së paku të pastra. Nëse nuk i posedonin, ato i huazonin nga ndokush, në mënyrë që të dukeshin sa më të bukur e më dinjitozë.

Veshjet tradicionale që i vishnin në tërë Malësinë e Madhe ishin: xhubleta (veshje e gjinisë femërore) dhe çakçirë e xhamadan me kopicë të bardhë - plis (veshje e gjinisë mashkullore). Veshja tradicionale e femrës dallohet për nga tipat e ndryshme të xhubletave: xhubleta e vajzërisë (me ngjyrë të zezë e me disa vija të bardha mbrapa), xhubleta e nusërisë, xhubleta e përditshme për punë shtëpie brenda dhe jashtë saj, pastaj xhubleta e grave dallohej nga ajo e plakave e kështu me radhë. Kur ndryshonin gjendjen statusore civile - nga vajzë në nuse apo grua - nuk e vishnin më xhubletën e vajzërisë.

Vajzat që mbetnin pa u martuar (vajza të virgjëra)⁶ për arsye të ndryshme (për të ruajtur nderin e familjes, për të udhëhequr shtëpinë etj.) vazhdonin ta mbanin xhubletën e vajzërisë. Disa nga ato që hiqnin dorë nga martesë (të ashtuquajtura burrëresha apo *tobeli*⁷), përbetoheshin se nuk do të martoheshin, merrnin rolin e mashkullit, rrethi shoqëror i pranonte, dhe statusi i tyre në shoqëri njihej si e drejtë zakonore.

T'i kthehemi klasifikimit të veshjes së nuses. Më e bukura, apo më e mira ndër xhubleta konsiderohej *xhubleta e nusnisë* me *rrzhgjâte* (stoli - aksesore nga argjendi), cohë të stolisur me *rrueza* dhe gurë të çmuar, si dhe me *duvak* në formë koni që vihej përmbi kokë. Nusja

⁶ Parafrazojmë Andromaqi Gjergjin që shkruan për kategorinë e veçantë të vajzave, që ishin *virgjina*. Në Malësi të Madhe (rr. Shkodër), hiqnin në mënyrë vullnetare e botërisht dorë nga martesë, ndërrojnë emrin, rrinin me burra, merrnin pjesë në luftëra, nuk bënin punë grash, udhëhiqnin shtëpinë, prisnin flokët, visheshin me tirq si burra etj. Për më shumë shih: Andromaq Gjergji, *Veshjet shqiptare në shekuj*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, 2005), f. 84.

⁷ Tobeli – betimi për të mos u martuar.

kishte për detyrë të përgatiste nga tri ose pesë e deri në shtatë xhubleta. Por, kishte raste kur për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike - *fukarallëkut*, ngaqë jo të gjitha familjet kishin mundësi, disa familje nuk mund të siguronin pesë, por vetëm tri xhubleta, kurse kohëve të fundit vetëm një, derisa i kanë hequr krejt nga përdorimi. Xhubleta me të cilën nusja shkonte te burri, ditën e dasmës, ishte më e mira dhe quhej “xhubleta ma e mirë” ose “xhubleta e parë”. Ato dalloheshin sipas cilësisë, rastit të përdorimit dhe renditjes (xhubleta e parë, xhubleta e dytë, xhubleta e tretë, por edhe si *xhubleta e pas s'mirs* e kështu me radhë). Ato më të mirat nuk visheshin përditë, por në raste të veçanta (kur shkonin në kishë, kur shkonte nusja *nrikull te kumara*, për hatre/në raste vdekjesh). Nuset që ishin martuar atë vit, dilnin në logje për festa, të “Dielën e Pashkëve”, të “Hanën e Pashkëve”, pastaj për *Shënkollë* etj., kështu, nuset e reja të veshura me xhubletat më të bukura nusërie dhe të stolisura me aksesore, janë ekspozuar sikur të ishin në një garë *Miss*-i. Më e bukura është marrë nëpër gojë më së shumti dhe është folur për të vite me radhë, se si filania ka pasur *laft*, ose si ka dalë *dai*.

Kurse xhubletat e tjera me më pak cilësi e pa aksesore janë veshur për punë shtëpie, për punë në ara, në çobani etj. Këto xhubleta i kanë mbajtur gjatë gjithë jetës. Kur vdiste gruaja (plaka) i vishnin xhubletën më të mirë, me të cilën edhe e varrosnin, bashkë me aksesore/stoli.

Paja e nuses dhe t'falat e saj. Paja në Malësi njihet si *petkat* ose *takâmi* i nuses. Kurse, *të falat*, si pjesë e pajës janë peshqeshet apo dhuratat që nusja u sjell të afërmve të saj e të burrit.

Xhubleta është punuar prej leshit të deleve, me spik e copa rripash të ngushtë shajaku dhe me gajtan. Xhubleta ngjyrosej kryesisht me ngjyrë të zezë dhe pjesa e fundit, gajtani, lihej me ngjyrë të bardhë. Rrallë gjejmë lloje të tjera të ngjyrave si e kuqja apo ngjyra vjollcë, sepse kanë shkuar duke u zbehur apo hequr nga përdorimi. Kushdo s'mund ta qepte e ta përgatiste një xhubletë, sepse ajo ka një teknikë ndërtimi të ndërlikuar. Veçoheshin ato gra që i punonin xhubletat. Xhubleta e porsapunuar duhej të rrinte e ngulur si e ngrirë. Forma e

saj ishte si një fund i gjatë dhe në formë të kabanës. Dy pjesët e saj të prapme ishin të valëzuara, me një hapësirë mbrapa që i mundësonte lëvizjen e lirë të këmbëve. Sipër, në krahët e supet ishte e zhveshur dhe mbahej me dy *krahca*. Xhubletën e kanë punuar gratë me aftësi krijuese dhe prirje artistike, por edhe ato që kanë ditur ta riprodhojnë. Simbolet dhe motivet e larmishme që gjenden në xhubleta kanë kuptimet e veta reale dhe fantastike, disa vijnë nga lashtësia që kanë qenë në shërbim të jetës tokësore, mitologjike, por edhe botës së përtejme.

Pjesët e xhubletës janë: Opâkt, çarapt e lulzuem (me shqipe etj.), bythaçi i grave, rasha e leshit për nâr xhublet, pshtjellaku, bohçja, ruba e brëzit/postavës, postava ose brëzi, ruba me thek, këmisha, grykca me pafta ose grykolja, kraholi ose mallota, xhoka, tallagani, kapica e nuses, ruba leshit, ruba serrmit, ruba rretit, duvaku, ruba e duvakut etj.

Rrzhgjâti (ose *serrmi*, stolitë e argjendta) për xhubletë përfshin: *kapicën e nuses me dekorimet e saj, vjerrcat e flokëve, hajmalinë me varq, varqit e brëzave, mashicat me varq, paftën e postavës, paftat e grykcës, varqit me shqiponjë, varqit me kryq, mhyrtë, bylyzykt dhe groshatoret për stoli.*

Xhubletat janë hequr gradualisht nga përdorimi, por më vonë se veshja e burrave. Përdorimi dhe prodhimi i xhubletës kanë qenë në rënie gjatë dekadave të fundit të shekullit XX, për arsye socio-politike dhe ekonomike të vendosura nga sistemi i kohës, sidomos në Shqipëri në vitet 1960 e mbrapa, ku socializmi ndryshoi modelet tradicionale kulturore. Ndërsa në Mal të Zi është ruajtur pak më gjatë. Në zonën malore është hequr më vonë, sesa në atë fushore. Fillimisht është hequr duvaku, e më pas xhubleta që është zëvendësuar me fustan të bardhë. Disa bartës tregojnë rastet e tyre familjare. Bartësi 60 vjeç (Zef Gjokë Dedvukaj) tregon: *Shtir kanë marr guxim me fillua me i hjek. I pari â kën Gjok' Marash Uci ën Spí t' Hotit, ku me 1953 ia ka hjek t'shoqes duvakun, e ën ditë t'vjets ja ka hjek edhe xhubletën dhe e ka kalua ën rash palë-palë. Por, gruaja e tij Pashkë Novja i ka thanë: Vet nuk e veshi rashën se jam e bija e Nua Uc's, e zdua me korit babën e*

nanën për t'gjallë. Ajo s'ka da me ja marr ftyrën ropve. Ater i ka than burrit: ën po thua me vesh vet rashën, po e veshi, por, ën breg t'Tuzit ën rash nuk ulëm pa ty. Burri nuk e ka lanë vetëm, ajo e ka vesh rashën dhe janë ulë bashkë te dy.

Mbasi janë hequr xhubletat nga përdorimi, si veshje e përditshme, mjerisht janë ruajtur shumë pak. Një pjesë e njerëzve xhubletat i kanë lënë pas dore, ato janë kalbur nga shiu, e djegur nga dielli, kurse të tjerët i kanë shitur. Të njëjtin fat kanë pasur edhe stolitë e argjendit (rrzhgjâtet), përveç kompensimeve në formë parash, ato i kanë kompensuar edhe me enë gatimi (kusia) nga romë e egjiptianë endacakë.

Gjelosh Nikë Junçaj, por edhe disa bartës të tjerë (Lukë e Lenë Junçaj) thonë se Agia, nëna e Gjeloshit u varros e fundit me xhubletë. Gjeloshi tregon për nënën e tij Age Bacën e Baca Niks, që e mbajti xhubletën veshur tërë jetën, me ndershmëri dhe krenari, deri në vitin 1983, kur edhe e varrosin me të. *Agia kurrë s'ka vesh rashë. Ajo s'ka da me korit vjehrrin për t'gjallë*, shprehet Gjeloshi. Në Hot, i fundit që i ka hequr nga përdorimi i përditshme çakçirët e xhamadanin është Dedë Prëç Gjonaj nga Narhelmi, në vitin 1983. Për këtë tregon nipi i tij Besnik Gjonaj (35-vjeçar), por këtë e dëshmojnë edhe disa bartës të tjerë (Zef Dedvukaj, Smail Çunmulaj etj.).

Xhubletës i janë thurur këngë të ndryshme, por edhe valle. Pothuajse nuk ka dasmë e aheng që nuk përmendet në ndonjë tekst të këngës në zonën e Malësisë së Madhe, këndeje e andej kufirit, por edhe në kudo në botë ku ka lidhje me të. Po përmendim dy vargje të një këngë - valle që e këndojnë këngëtarët e njohur të Malësisë, si meshkujt, ashtu edhe femrat, por që është kënduar edhe nga Grupi i rrethit të Shkodrës në Festivalin e Gjirokastrës në vitin 1988: *“O cila jem çeta më e mirë, jekjo çeta me çakshir. O çeta e mirë po duket vetë, çeta veshun me xhubletë...”*. Këngë enkas për xhubletën kanë krijuar, mbas shpalljes në mbrojtje nga UNESCO-ja, si risi e kohës që solli vetëdije të zgjuar kombëtare kompozitori Zef Çoba, me tekst të Tonin Ndrecës, kënduar nga Vida Kunora “Xhubleta arbnore”. Pastaj kompozimi nga Valter Beqo, me tekst të Palë Qarraj, kënduar nga

Dritan Nutaj “Me xhubletë e me kunorë”. Fran Kodra krijoi tekstin dhe muzikën për këngëtarën Viola Shqau “Moj xhubleta iliriane”, por edhe instrumentale e valle. “Xhubletën malësorët e kanë bartur me vete kudo në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e deri në Australi, e jo më këngën që këndohet nga thellësia e shpirtit. Xhubleta gjendet në muze të vendeve të ndryshme me famë botërore.

Xhubleta sot

Përveçse gjendet si eksponat në muze të ndryshme, si traditë e mirëfilltë dhe kulturë kombëtare, ajo vazhdon të jetojë përmes shoqërive kulturore-artistike, manifestimeve të ndryshme kulturore si *Miss bjeshka* që organizohet në Koritë, në muajin gusht për festë të Shën Shtjefnit, kur çobanët bashkohen dhe ndonjëherë për ndonjë festë si ajo e Shën Kollit dhe për Pashkë, por edhe si pozim për fotografim të çifteve me veshje kombëtare. Rrallëherë shfaqet ndonjë çift ditën e dasmës ose mbas saj për të krijuar fotoalbum, e tëra kjo si simbol i nostalgjisë e shenjë e traditës së lavdishme malësore e shqiptare.

Duhet falënderuar të gjithë ata që kanë dhënë kontribut në shoqëri kulturoro-artistike, që xhubletën e kanë veshur në role të ndryshme si aktore, valltare, kërcimtare e këngëtare. Këtu dua të veçoj shoqëritë: Besa e Trieshit, Hoti sot Dedë Gjon Luli dhe Rapsha, por edhe të tjera, që gjithherë kanë dalë autentikë në skenë, edhe sot e kësaj dite. Xhubleta ishte element identifikues i malësores si shqiptare kudo që shfaqej në skenat e ndryshme nëpër Jugosllavi.

Në raste kur sot vishet xhubleta, në manifestime tradicionale (shfaqje të shoqërive kulturoro-artistike, festivale folklorike, në *Miss bjeshka* etj.), një pjesë e të rinjve nuk dinë ta dallojnë se a është veshje nuseje apo vajze. Në këto raste ndodh që femrat e veshura me xhubletë të mos e respektojnë etikën tradicionale të veshjes, sjelljes, vallëzimit e kërcimit me xhubletë.

Gjyshet tona i kanë punuar xhubletat, madje edhe sot e kësaj dite, me pasion edhe pse në moshë të thyer, Tole Lekë Berishaj i punon ato. Po ashtu, ndër koleksionistët e dalluar është Vahid Turuskoviç

me bashkëshorten Nevinën. Muzeu i Malësisë, me pronar Shtjefen Tomë Ivezaj, e pasuron krejt Malësinë e Madhe me eksponatet që posedon. Në punim e sipër është Biblioteka dhe Muzeu Patër Vinçenc Malaj në Tuz që kanë të konservuara xhubleta me stoli e së shpejti do të ekspozohen. Koleksionistja Shaqe Dushaj me pasion i ka kujdes dhe i paraqet ato në medie, në shfaqje të ndryshme, por edhe para nxënësve të shkollave në Malësi. Anton (Ton Kaçeli) Sinishtaj i pasionuar për etnokulturë. Deshi i Nua Prëç Lekoçaj e ka të trashëguar komplet xhubletën me stoli. Familja e Pal Tosh Dedivanaj e ka trashëguar veshjen e xhubletës të kompletuar me stoli dhe me *xhokë* origjinale, që vetëm kjo familje e ka në Malësi. Sigurisht ka edhe të tjerë individë që i kanë të kompletuara xhubletat.

Pasi UNESCO pranoi xhubletën në *Listën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale nën mbrojtje*, Komuna e Tuzit shpalli vitin 2023 - Vitin e Xhubletës, ku realizoi disa veprimtari:

Krijoi logon e Vitit të xhubletës. Vendosi siglën nëpër dokumente e shkresa zyrtare. Krijoi vitrinën dhe vendosi xhubletën në të, në korridorin e ndërtesës së saj. Vendosi muralin në ballinën e ndërtesës së Komunës. Bëri kërkesën dhe Posta e Malit të Zi e aprovoi pullën postare Godina xhubljete “Viti i xhubletës”, pra xhubleta është në filatelinë e Malit të Zi. Në Koloninë tradicionale artistike “Një gotë për Gjeloshin” kushtuar piktorit malësor me famë, këtë vit kishte edhe shenjën dalluese të Vitit të xhubletës që pikturuan për tri ditë me radhë në zona të ndryshme të Malësisë me tematikë xhubletën. Komuna e Tuzit shpalli “Qytetare nderi” Tole Berishaj, mjeshtren e fundit të gjallë në Malësi. U organizoi Simpoziumi shkencor “Xhubleta, dëshmitare e lashtësisë sonë”, të gjitha kumtesat u mblodhën dhe u botuan në librin me të njëjtin titull.⁸

Organizoi Sfilatën me xhubleta në Sheshin e ri pranë shkollës së mesme. Enkas për këtë rast koreografi Shtjefën Ujkaj përgatiti koreografinë me titull *Vallja e xhubletës*. Po ashtu, fotografoi dhe botoi fotoalbumin me xhubleta dhe i ekspozoi ato. Dhe për fund

⁸ Komuna e Tuzit, arka e vlerave që mbron UNESCO, *Xhubleta, dëshmitare e lashtësisë sonë*, (Tuz: 2024).

realizoi Konkursin publik letrar kushtuar xhubletës dhe ndau tri çmime për poezi dhe prozë kushtuar xhubletës.



Foto 2. Çifti⁹ malësor me çakçirë e xhamadan dhe me xhubletë

⁹ Kjo fotografi me veshje kombëtare është bërë (nga Vinko Gj. Prenkoçaj) për kujtim të martesës (6.4.2013) së Luigj dhe Veronikë Dedvukaj, te Shtëpia Muze e Dedë Gjo' Lulit në Bardhaj të Hotit, Komuna e Tuzit, më 8.2. 2015. Fotografia është marrë nga arkivi personal i Luigj Dedvukaj.

Bibliografia

Berishaj, Anton K. *Virgjëria e përbetuar – Jeta ndërmjet detyrimit dhe vetëflijimit*, (Prishtinë: ASHAK, 2016).

Berishaj, At' Kolë P. *Sofra në Malësinë e Madhe*, (Ferizaj: Drita, 1990).

Dedvukaj, Luigj. *Ceremoniali i dasmës në Hot*, (Tuz: 2016).

Gjergji, Andromaqi. *Veshjet shqiptare në shekuj*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, 2005).

<https://ich.unesco.org/en/USL/xhubleta-skills-craftsmanship-and-forms-of-usage-01880>

Komuna e Tuzit, arka e vlerave që mbron UNESCO, *Xhubleta, dëshmitare e lashtësisë sonë*, (Tuz: 2024).

Ujkaj, Shtjefën Kola. *Vallet dhe lojërat e Malësisë*, (Tuz: Sh. Ujkaj, 2019).

Young, Antonia. *Gratë që u bënë burra. Virgjineshat e betuara shqiptare*, (Tiranë: Skanderbeg Books, 2013).